



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:085546
Datë: 30.12.2024
Numri i dokumentit: 06667812

K.DH.SH.II.nr.237/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, gjyqtari Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “VB Tofaj” shpk, me numër unik identifikues 810962193, me adrese ne Junik, te cilin e përfaqëson F.T pronar, kundër debitorit Komuna e Junikut, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.309/23 dt.29.09.2023, me datën 30.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Junikut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.309/23 dt.29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.309/23 dt.29.09.2023, ka refuzuar ne tërësi si te pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Junikut, ndërsa ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.120/23 dt.08.02.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Valdrin Beka me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te cenimit thelbësor i dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta ndryshoj ndërsa propozimin ta refuzoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “VB Tofaj” shpk, me numër unik identifikues 810962193, me adrese ne Junik, te cilin e përfaqëson F.T pronar, më datën 08.02.2023, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Komuna e Junikut, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.521-2021 dt.03.12.2021. Përmbarruesi Privat Valdrin Beka me seli ne Prishtinë, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.120/23 dt.08.02.2023, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’i paguaj shumën prej 119,333.60 euro, me kamatë prej 8% ne vit nga dita e arritjes se kërkesës për pagesë si edhe shpenzimet e procedurës se përmbarrimit.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 14.02.2023 duke e kundërshtuar urdhrin për përmbarrim me arsyetimin se nuk janë kryer punët e kontraktuara sipas Kontratës 636-19-026-5-2-1 dt.03.12.2021. Nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 37 par.1 te LPP, fatura e bashkangjitur propozimit për përmbarrim nuk është ne origjinal apo kopje e vërtetuar e po ashtu nuk e ka paraparë kohen e përmbushjes e detyrimit nga debitori, nuk ka përshkrim te qarte te shërbimeve pra nuk janë plotësuar kushtet nga neni 29 apr.3 dhe nenit 43.4 te LPP, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbarrimor ta anuloj dhe te obligohet qe kreditori ti paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për prapësim.

Përgjigje ndaj prapësimit te debitorit ka ushtruar kreditori me datën 23.02.2023, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit ne prapësim si te pabazuara, kreditori nuk ka lëshuar fature për punët e pakryera por ka lëshuar faturë për punët qe janë kryer për çka vërteton edhe pranimit i punëve nga mbikëqyrësi i projektit, shton se fatura është lëshuar sipas nenit 24 par.2 te Kontratës për situacionin e dytë te punëve te realizuara. Fatura e bashkangjitur propozimit për përmbarrim është ne origjinal te cilën debitori e ka pranuar dhe nënshkruar ashtu qe plotëson kushtet ligjore nga neni 29 par.1.3 dhe 3 te LPP, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, urdhri përmbarrimor te mbetet ne fuqi dhe te obligohet debitori te paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore dhe shpenzimet e përpilimit te përgjigjes ne prapësim ne shumen prej 650 euro sipas TOA.

Gjykata Komercale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.309/23 dt.29.09.2023, me të cilin e ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka arsyetuar se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarrimi është dokument i besueshëm dhe i përmban te gjitha elementet e kërkuara ne përputhje me nenin 29 dhe 37 te LPP dhe ne bazë te tyre mund te caktohet përmbarrimi. Kjo faturë ka tiparet e dokumentit te besueshëm sepse përmban te gjitha te dhënat e kërkuara me ligj, është pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori si dhe është dorëzuar ne origjinal gjë qe vërtetohet nga vula e pranimit dhe numri i protokollit. Pra nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore për anulimin e lejimit te përmbarrimit, andaj edhe ka vendosur si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme me rastin e vendosjes, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbaremi është lejuar në bazë të faturës nr.521-2021 dt.03.12.2021 e lëshuar nga kreditori e cila propozimit për përmbaremi i është bashkëngjitur ne origjinal dhe ne pajtim me nenin 37 të LPP i cili parasheh që *“kur propozimi për përmbaremi paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Kjo faturë është e nënshkruar dhe e vulosur me vulë të protokollit nr.9-155/10913 dt.03.12.2021 nga organi kompetent i debitorit Komuna e Junikut si Institucion Publik, element ky bazë qe shpreh vërtetësinë e një dokumenti, se i njëjti është pranuar ne mënyrë të rregullt dhe qe ka cilësinë e dokumentit te besueshëm konform nenit 29 të LPP-së dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbaremit, sepse i përmban elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaremi po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Prandaj, bazuar ne këto arsye, Gjykata e shkalles së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj te bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu qe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkalles së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe ne konstatim te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Edhe Gjykata e shkalles së dytë analizoi pretendimet e debitorit se lejimi i propozimit për përmbaremi ne baze te faturës është i palejueshëm sepse kreditori me datën 01.09.2021 ka kërkuar zgjatje te afatit për ekzekutim te punëve dhe se nuk janë realizuar punët e kontraktuara nga ana e kreditorit ashtu qe projekti nuk është arritur te finalizohet sipas Kontratës 636-19-026-5-2-1 dt.03.12.2021, puna është pezulluar qe nga viti 2021 kur është bere kërkesë për shtyrje. Mirëpo këto pretendime nuk qëndrojnë sepse ne shkresat e lendes gjendet raporti i datës 03.12.2021 me nr. prot.9-180/10910 lëshuar nga Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues Komuna e Junikut, përmes se cilit konstatohet se punët ne projektin Rregullimi i shtratit te Lumit Erenik-Junik pozicionet e kryera ne situacionin e dytë janë kryer sipas kontratës 636-19-026-5-2-1 duke konstatuar se këtij raporti i bashkëngjitet situacioni i punëve te kryera, andaj këto pretendime gjykata e shkalles së dytë i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbareme mbi bazën e parimit te rigorozitetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbaremi i cili përmban

aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.237/24, me datë 30.12.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova